

EPO ANCHOR



PËRSHKRIMI

Ngjitës universal me bazë epokside.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Ngjitës 2 – komponentësh
- Nuk përmban solvent
- Rezistenca të larta në ngjeshje, përkulje si dhe forcë ngjitëse
- Rezistent ndaj disa acideve, alkaleve, agjentë gërryes për beton, agjentë pastrimi, uji detit dhe ujë të kripur
- Punueshmeri e shkëlqyer

FUSHAT E APLIKIMIT

EPO ANCHOR aplikohet në ato ambiente ku kërkohet forcë e lartë ndaj ngarkesave mekanike dhe rezistencë ndaj agjentëve kimike. Produkti përdoret për ngjitjen e materialeve të ndërtimit në ambiente industriale. EPO ANCHOR shërben për ngjitjen e membranave TPE në fugat e dilatimit duke i rezistuar presioneve negative dhe pozitive.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Baza	Rezinë epokside 2 - komponente
Ngjyra:	Gri
Viskoziteti:	1,000,000 mPa.s (Spindle F; rpm 2.5)
Raporti përzierjes:	1:1 në peshë
Dendësia:	1,75 Kg / lit në 23°C
Jetëgjatësia:	Afërsisht 60 min në 23°C
Temperatura minimale për forcim:	+100C
Rezistenca në ngjeshje:	70 N / mm ² (DIN EN 196 - 1)
Forca në përkulje:	> 40 N / mm ² (DIN EN 196 - 1)

SIPËRFAQIA

Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër, e qëndrueshme, pak e ashpër dhe pa materiale që parandalojnë lidhjen, të tilla si pluhur, vajra etj. Nëse është e nevojshme, sipërfaqja duhet të parapërgatitet me larje, ashpërsim, etj, dhe në raste të mureve, fërkohet me një furçë teli apo një paisje tjetër e ngjashme.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Komponenti A (rezina) dhe komponenti B (forcuesi) janë mbushur në dy kova të veçanta, në proporcion të paracaktuar në raport peshe. E gjithë sasia e komponentit B duhet shtuar në enën e komponentit A. Përzierja e 2 komponentëve duhet të bëhet për rreth 5 minuta, duke përdorur një mikser me shpejtësi të ulët (300 rrotullime / min). Është e rëndësishme që për të arritur një përzierje të plotë të përzihet mirë pranë anëve dhe në fund të kovës, në mënyrë që të arrihet një shpërndarje uniforme e forcuesit.

PROÇEDURA E APLIKIMIT

Produkti aplikohet duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar ose një spatul në mënyrë që të bëhet një shpërndarje uniforme në të gjithë sipërfaqen. Materiali që do ngjitet, vendoset mbi materialin e hapur duke i ushtruar presion dhe duke i lëvizur deri sa të jenë në pozicionin e dëshiruar.

IZOLIMI I FUGAVE TË DILATIMIT

Fugat duhet të jenë të pastra dhe të thata në mënyrë që të bëhet aplikimi i produktit me anën e një spatule metalike në trashësi 1 mm në drejtim me drejtimin e fugës. Para se të bëhet aplikimi i produktit, 2 cm nga këndi i fugës mbulohet në të dyja anët me ngjitës letre. Mbas aplikimit të produktit ngjitëset hiqen. Mbas kësaj vendoset membrana TPE duke kaluar me një spatul në mënyrë që të mos kemi krijimin e bulzave të ajrit. Mbas kësaj në mes të membranës TPE vendoset ngjitësi i letrës me gjerësi 5 cm dhe mbi këtë aplikohet 1.5 mm EPO ANCHOR.

KONSUMI

Si ngjitës pllakash: Rreth. 0.8 - 1 Kg/m²

PAKETIMI

Kova plastike 1Kg (A+B) dhe 5Kg (A+B)

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

24 muaj në qoftë se ruhet në paketim origjinal të mbyllur, në ambiente të mbrojtura nga lagështia dhe ekspozimit të drejtpërdrejtë në diellit. Temperatura e magazinimit rekomandohet ndërmjet +5°C dhe +35°C.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gjelltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

